REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2019:135942
Datë: 14.10.2022
Numri i dokumentit: 03530538

**C.nr.707/2018**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË**, me gjyqtarin Robert Tunaj dhe bashkëpunëtorin profesional Feim Bytyqi, në çështjen kontestimore të paditësit M. B. nga fshati Gj. Komuna e Suharekës të cilin me autorizim e përfaqëson Av.I. Xh. – K. nga Suhareka kundër të padituve H. B. dhe R. B. që të dy nga fshati Gj. Komuna e Suharekës, me objekt kontesti vërtetimi i pronësisë, me vlerë të kontestit 1000 euro, në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 30.09.2022 në prani të të autorizuarës së paditësit av.I. Xh. –K. dhe të paditurit H. B. e në mungesë të të paditurit R. B. , mori, ndërsa me 14.10.2022 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** në tërësi si e pa bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit M. B. nga fshati Gj. Komuna e Suharekës me të cilën ka kërkuar që të:
“ VËRTETOHET e drejta e pronësisë së paditësit në parcelat P-..... në sipërfaqe 276 m2 dhe P-..... në sipërfaqe 276 m2 në vendin e quajtur A. e G./J. në ZK Gj. dhe të DETYROHEN të padituri që paditësit t’ia pranojnë të drejtën e pronësisë së këtyre ngastrave”.

Shpenzimet e procedurës i bart secila palë të vetat.

A r s y e t i m

Paditësi M. B. nga fshati Gj. Komuna e Suharekës, përmes të autorizuarës së saj Av.I. Xh. – K. nga Suhareka, pranë kësaj gjykate me datë 31.12.2018 ka parashtruar padinë me kërkesëpadi për vërtetimin e pronësisë dhe bartjen e pasurisë kundër të padituri H. B. nga fshati Gj. , me të cilën ka kërkuar që e njëjta të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe që të vërtetohet e drejta e pronësisë së paditësit në parcelat P-..... në sipërfaqe 276 m2 dhe P-..... në sipërfaqe 276 m2 në vendin e quajtur A. e G./J. në ZK Gj. si dhe të detyrohet i padituri që paditësit t’ia pranoj të drejtën e pronësisë juridike të këtyre ngastrave.

Gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore ka mbajtur seancën përgatitore me dt.23.02.2022 dhe seancën e shqyrtimit kryesor me datat 10.03.2022; 22.07.2022 dhe me dt.30.09.2022.

E autorizuara e paditësit Av. I. Xh. – K. në seancën përgatitore të mbajtur me datë 23.02.2022 ka zgjeruar kërkesëpadinë për parc.1076-1 konform nenit 264 lidhur me nenin 263 të LPK-së dhe ka bërë zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv ku ka shtuar si të paditur edhe R. B. pasi që në vitin 2019, do të thotë pas parashtrimit të padisë në këtë gjykatë është bërë tjetërsimi

2019:135943

i kësaj parcele dhe nga viti 2019 pronar juridik është R. B. . Në seancën e dt.10.03.2022 e autorizuara e paditësit ka deklaruar se mbetet në tërësi si në deklarimet e seancës se dt.23.02.2022, lidhur me kërkesëpadinë e cila ka të bëjë me vërtetimin e pronësisë mbi bazën e mbajtjes në mirëbesim i ka propozuar gjykatës se për të vërtetuar faktin se këtu paditësi M. B. është në posedim dhe shfrytëzim në mirëbesim mbi 30 vite për parcelën me nr....., ta nxjerr provën me ekspertizë gjeodet ku në rastin konkret do të vërtetohet saktë se cila është sipërfaqja të cilën e shfrytëzon dhe posedon këtu paditësi. Edhe përgjatë shqyrtimit të seancës kryesore e autorizuara e paditësit ka mbet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë ndërsa në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se është vërtetuar fakti se këtu paditësi M. B. e shfrytëzon dhe e punon pjesën e ngastrës .... në sipërfaqe 41 m2 dhe në këtë drejtim edhe e precizon kërkesë padinë duke kërkuar që të vërtetohet se paditësi M. B. është pronar i pjesës së ngastrës .... në sipërfaqe prej 41m2. Me pretendimin se gjendja faktike është vetëtuar me ekspertizën e gjeodetit e dt.15.09.2022 sa i përketë diferencës së ndërhyrjes apo pjesës të cilën paditësi e kërkon që të vërtetohet pronësia për këtë parcelë dhe kjo diferencë e sipërfaqes është 41 m2, që të paditurit do t'ia pranojnë. Baza e kërkesëpadisë se kufijtë për këtë parcellë do të duhej të ishin përmes vijës së jarugës qka është vërtetuar edhe nga dëgjimi i palëve ndërgjyqëse, gjithashtu edhe nga deklaratat e dëshmitarve. Prova më e rëndësishme e të cilën gjykata duhet ta vlerësoi si më të rëndësishme është deklarata e datës 10.03.2022 e të paditurit H. B. i cili ka deklaruar se kufiri i ngastrave do të ishte për vij të J. . Ky fakt është vërtetuar dhe është parë edhe me daljen në teren nga gjykata, andaj bazuar mbi të gjitha këto prova të administruara i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit M. B. ta miratoi si të bazuar në tërësi dhe të vërtetohet fakti se paditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë për sipërfaqen prej 41 m2 në parcelën ..... . Njëherit i ka kërkuar shpenzimet gjyqësore në shumë të përgjithshme prej 730 euro dhe atë të specifikuara , 104 euro për padi, 20 euro për taksë gjyqësore, 200 euro për ekspertizë si dhe për tri seanca të mbajtura nga 135 euro.

I padituri i parë H. B. në seancën përgatitore ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit duke shtuar se unë në këtë çështje fare nuk jam i involvuar, nuk jam palë ,kjo pronë nuk është e imja, me rastin e ndarjes i ka takuar R. B. , gjykatës i ofroi si provë çertifikatën e pronës me nr ..... dhe kontratën me nr. LRP nr ..... me numër reference .... e dt.29.03.2019. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se kjo parcelë është nda në dy pjesë të barabarta në vitin 2018, i kanë kufijtë e vet dhe që të dy parcelat unë i kam bartur me kontratë pronarëve në pjesë të barabarta, andaj kërkoj që padia dhe kërkesëpadia të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

I padituri i dytë R. B. deklaron se e kundërshton kërkesëpadinë, duke shtuar se prona është ndarë para 30 viteve, mirëpo para dy vitesh me insistimin tim H. e ka ndarë edhe faktikisht dhe juridikisht këtë pronë duke e bartur në emrin tonë. Në ketë çështje ka një ekspertizë dhe një skicë tereni e cila është bërë nga eksperti K. G. , mbi bazën e të cilës është kryer parcializimi dhe ndarja e ngastrës e më pas edhe regjistrimi në kataster me kërkesë që kërkesëpadia të refuzohet në tersi e pa bazuar.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e provave nga shqyrtimi i mbajtur në këtë gjykatë, bëri administrimin e provave dhe atë bëri leximin e: çertifikatës së pronës nr. .... , kontratën mbi dhurimin LRP nr. ... , kontratën mbi dhurimin LRP nr. ... , çertifikatën e pronës ..., historiatin e parcelës dhe ekspertizën e ekspertit gjeodet L. A. të dt. 15.09.2022 me skicën e terenit të dt. 20.10.2018, bëri dëgjimin e palëve në cilësi të palës dhe dëshmitarëve P. B. dhe S. B. që të dy nga fshati Gj. Komuna e Suharekës.

Gjykata pas vlerësimit të provave materiale, deklarimeve të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave të lartcekura në kuptim të nenit 7 dhe 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar dhe vlerësuar çdo provë veç e veç dhe të gjithat së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është **e pa bazuar**.

Paditësi M. B. në cilësinë e palës ndërgjyqëse në seancë ka deklaruar se për pjesën e parcelës që e kam bërë kërkesëpadinë jam në posedim që nga viti 1974 dhe asnjëherë nuk jam penguar nga dikush e të njëjtën e kam edhe sot në shfrytëzim. Pikë kufizuese e parcelës ka qenë braza – jaruga të cilën e kemi pas përgjysmë dhe janë të vendosura shtyllat e betonit, me rastin e ndarjes marrëveshja ka qenë me shkrim të cilën e posedon R. atë marrëveshje, unë nuk e kam marrëveshjen dhe jemi marr vesh qysh najë kanë lënë prindërit me shfrytëzua. Kur janë vendos pikat unë nuk kam qenë, më ka njoftuar R. vetëm me pikat të cilat veç i kishte instaluar në kompjuterin e tij, në teren kam qenë por pikat nuk janë qit në prezencën tonë, i padituri i parë ka qenë në dijeni se lënda me padi është proceduar në vitin 2018 dhe këto parcela kanë qenë kontestuese. Me dëgjimin e tij si palë gjykata ka vërtetuar faktin se ngastrat objekt kontesti në vazhdimësi kanë qenë të pa definuara qartë, kufiri i tyre edhe më parë është kontestuar dhe se kishte pasur kontest gjyqësor mes palëve qka pretendimin se e mban me mirëbesim dhe pa penguar nga askush e bënë të rrëxueshëm dhe jo bindës për gjykatën. Për me tepër kjo deklaratë është në kundërshtim të plotë me deklaratën dëshmitarit P. B. i cili thekson se ngastra ..... është e imja dhe e njëjta është ndarë për gjysme me ngastrën 1076-1 pronë e të paditurit të dytë por edhe me provat materiale si qertifikata e pronës , historiati i ngastrës ,konstatimi i gjykatës me ekspert gjeodet në teren ,ku paditësi fare nuk është pronar i ngastrave objekt i padisë.

I padituri i parë H. B. në cilësinë e palës ndërgjyqëse në seancë ka deklaruar se paditësin dhe të padituri R. i kam nipa, unë jam ndarë me babait e tyre para shumë vitesh, më duket se ka qenë viti 1974. Parcela për të cilën po zhvillohet kontesti ka qenë jarugë, ajo parcelë ka pas diku rreth 0,70 ha, e njëjta është ndarë në tri pjesë. Në njërën anë të jaruges ka qenë I. babai i R. , ndërsa në anën tjetër unë dhe babai i M. . Kufiri i ngastrave ka qenë për vij të jarugës. Në vitin 2018 kemi qenë me gjeodetin K. G. dhe A. F. dhe të njëjtit i kanë gjetur kufijtë e ngastrave, si jarugë ajo ishte hekur si sipërfaqe prej tatimit po figuronte në emrin tim, krejt toka ka qenë në emër të babait tim, prej tij ka kaluar në emrin tim ndërsa unë me kontratë javë kam bartur paditësit dhe të padituri sipas ndarjes që kishte ndodhur para shumë vitesh. Ditën kur është matur dhe është ndarë kjo parcelë nuk ka pas asnjë mosmarrëveshje, mosmarrëveshjet kanë lindur më vonë. Me qatë skicë dhe qatë ndarje që është hartuar nga gjeodeti ky është regjistruar pronar i ngastrës. P. B. është vëllai i M. këtu paditësit dhe jetojnë bashkë. I kontestoj shtyllat që janë vendosur në pjesën ku e shfrytëzon dhe posedon M. . Marrëveshjen me shkrim unë nuk e kam, unë e kam vetëm kontratën të cilën kam qenë te noteri. Pikat janë gjetur nga gjeodeti dhe janë vendosur përmes pronës ndërsa qysh ka shkua jaruga ajo ka lëvizur vazhdimisht dhe kufiri tani nuk është përmes J. . Me këtë dëgjimin e tij gjykata ka provuar faktin se të paditurit H. B. imungon legjitimiteti real pasiv i palës pasi që palujtëshmeria objekt kontesti faktikisht prej vitesh nuk ishte e ti por edhe juridikisht me kontratat mbi faljen kishte kaluar në pronare legjitim R. dhe P. B. . Me këtë palë gjithashtu provohet fakti se paditësi M. B. fare nuk është pjesëtar në ngastrat ..... dhe ..... . E që kjo dëshmi është në përputhje të plotë me provat materiale ,qertifikatat e pronës për njësit katastrale .... dhe .... ,me historiatin e pronës .

I padituri i dytë R. B. në cilësinë e palës ndërgjyqëse në seancë ka deklaruar se ky kontest për mua ka qenë i zgjidhur, ka qenë gjeodeti në vend, janë vu pikat në prani timen, H. , S., P. dhe M. dhe të njëjtat pika që janë vu në teren K. i ka vendosur në skicë të terrenit dhe e ka regjistrua

në katastër. Atë ditë jemi marrë vesh ndërsa pse jemi në gjykate unë nuk e kuptoj. Kur jemi ndarë unë kamë qenë 7 vjeç, prona është ndarë në mes të prindit tim, prindit të paditësit dhe H. , ndërsa me kontratë te noteri është bërë në vitin 2019. Siç është bërë ndarja në teren M. dhe P. ashtu janë regjistruar në kadastër dhe është nënshkruar kontrata te noteri. Shtyllat i kundërshtoj pasi që paditësi vazhdimisht i ka lëvizur ato shtylla, aty ka qenë një dardhë por të njëjtën dardhë paditësi e ka shkul diku në vitin 2007 dhe pas vdekjes së vëllait ky vazhdimisht i ka lëvizur shtyllat. Nuk ka pas marrëveshje që kufijtë për këtë parcelë të vendosen përmes brazës së jarugës, ka pas mu ndarë në dysh. Me këtë palë gjykata ka vërtetuar faktin se palujtëshmeria objekt kontesti është ndarë faktikisht nga paraardhësi i paditësit dhe paraardhësi i tij me të padituri e parë H. B. dhe jo nga paditësi dhe i padituri i dytë ,dhe se paditësi asnjëherë nuk ka qenë pronar i asaj ngastre.

Dëshmitari P. B. në seancë ka deklaruar se në vitin 2018 është bërë ndarja e parcelës ..... , në mënyrën qysh u kanë gjendja në teren braza – telat, ne e shfrytëzojmë këtë parcelë deri në tela, bëhet fjalë për ngastrën e punuar e që në teren është e mbjellë bashqe, jaruga duhet me qenë kufiri në mes të ngastrave, kur është ndarë fizikisht parcela unë nuk kam qenë prezent aty, kam ardhur aty mbasi është kryer puna, unë nuk e di kur është ndarë bashkësia familjare në mes M. , H. dhe R. , por e di që atë ngastër e ka punuar baba edhe vëllazëria ndërsa R. e ka shfrytëzuar pjesën përtej brazës, domethënë ajo ngastër edhe para ndarjes në katastër ka qenë e ndarë në teren, nga viti 1990 ngastrën deri në brazë e ka punuar babai im. Telat rrethues i kam qit unë bashkë me babin tim në vitin 2006, kufiri është braza, por telat i kemi qit 20 deri 30 cm në anën tonë për shkak se nëse qiten në brazë rrezikon të mbyllet braza. Ky dëshmitar me pa mëdyshje provoj faktin se ngastra .... është pronë e tija dhe se ndarja në teren me kataster kishte ndodhur në vitin 2018 dhe se paditësi fare nuk është pjesë e kësaj ndarje ,po edhe me supozimin e të qenit pjesë e saj pretendimin se pjesën e ngastrën .... e mban me mirëbesim dhe pa penguar nga askush e bënë jo bindës për gjykatën dhe si të tillë gjykata e refuzon.

Dëshmitari S. B. në seancë ka deklaruar se unë kam lindur në vitin 1971, kur janë ndarë të paditurit me babain tim unë kam pas vetëm një vit, ndarjen nuk e mbaj në mend, mirëpo e di që jaruga që ka qenë në mes arës tonë dhe .... është pastruar vazhdimisht nga babai im, R. ka qenë përtej J. por J. nuk është llogaritur ndarje, mirëpo H. e ka ndarë këtë parcelë edhe nuk është deshtë me dal këndej jaruge. Telat janë vu në breg të jarugës rreth vitit 2005-2006 për mos mu mbyll jaruga pasi që jaruga vjen nga hyrja në fshat e përmes urës e trupon rrugën Suharekë – Prizren, kufiri për këtë parcelë është jaruga. Më herët ndarja ka qenë në drejtimin Veri Jug, ne kemi qenë përskaj të asfaltit, H. ka qenë në pjesën e epërme dhe jaruga ka qenë e H. , por diku në fillim të viteve të 1980 ka ndryshuar gjendja dhe e kemi ndarë ashtu siç është sot. Edhe me këtë dëshmitar provohet fakti se paditësi fare nuk ka qenë pronar i ngastrave objekt kontesti por pronar ishin paraardhësit e tij (babi dhe agjllarët ) dhe se H. të njëjtën e kishte ndarë dhe bartë te pronaret.

Me shikimin dhe leximin në çertifikatën e pronës nr. .... u konstatua se parcelat kadastrale P-..... në sipërfaqe 276 m2 dhe P-..... në sipërfaqe 276 m2 në vendin e quajtur A. e G.J. në ZK Gj. ishin të evidentuara dhe udhëhiqeshin në emër të pronarit H. A. B. nga fshati Gj. .

Nga shikimi dhe leximi në kontratën mbi dhurimin të hartuar pranë zyrës noteriale M. J. në Suharekë LRP nr. .... të dt.29.03.2019 u vërtetua se parcelën kadastrale .... në sipërfaqe prej 276 m2, H. A. B. përmes kontratës ia ka dhuruar këtë paluajtëshmëri kontraktuesit P. M. B. , ndërsa me kontratën mbi dhurimin LRP nr. .... u vërtetua se parcelën .... H. A. B. përmes kontratës ia ka dhuruar këtë paluajtëshmëri kontraktuesit R. I. B. , nga çertifikata e pronës .... e

dt.06.05.2019 u konstatua se parcela kadastrale ..... në sipërfaqe prej 276 m2 është e evidentuar dhe udhëhiqet në emër të pronarit R. I. B. nga fshati Gj. .

Me shikimin dhe leximin në historiatin e parcelës ..... ZK Gjinoc të lëshuar me dt.08.08.2022 nga Drejtoria për Shërbimin Pronësor Juridik, gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Suharekës u konstatua se kjo paluajtëshmëri ka qenë e regjistruar në emër të A. A. B. nga fshati Gj. e cila në vitin 2012 me Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Suharekë T.nr.6/2012 kjo paluajtëshmëri ka kaluar te trashëgimtari H. A. B. nga fshati Gj. . Në vitin 2018 parcela ... është parcializuar në .... rajon ujor në sipërfaqe 276 m2 dhe parcelën .... rajon ujor në sipërfaqe prej 276 m2 me pronar H. A. B. nga Gj. . Ndërsa në vitin 2019 me kontratat mbi dhurimin LRP nr..... dhe LRP.nr. ..... këto ngastra kalojnë në pronarët e ri dhe regjistrohen në emër të R. B. dhe P. B. .

Nga shikimi dhe leximi në ekspertizën e ekspertit gjeodet L. A. të dt. 15.09.2022 me skicën e terenit të dt. 20.10.2018 u konstatua se parcela kadastrale .... ZK Gjinoc në vendin e quajtur A. e G. në sipërfaqe prej 276 m2 me kulturë rajon ujor – lum është e evidentuar në emër të R. I. B. ndërsa parcela kadastrale ... ZK Gj. në vendin e quajtur A. e G. në sipërfaqe prej 276 m2 me kulturë rajon ujor – lum është e evidentuar në emër të P. M. B. . Gjendja faktike në teren ndryshon me gjendjen juridike pasi që rrethoja e telit dhe shtyllat e vendosura nuk ndjekin vijën katastrale por ka ndërhyrje në të dy ngastrat dhe atë në ngastrën .... në total 66 m2 ,ndërsa në ngastrën ..... në total 25 m2 .

Nga provat e administruara më lart dhe faktet e vërtetuara gjykata ka konstatuar se paditësi M. B. fare nuk është pronar në atë palujtëshmeri , sikurse edhe i padituri H. B. i cili këto palujtëshmeri mbi bazën e kontratës mbi faljen LRP.nr..... dhe LRP.nr..... ,pronësinë mbi ngastarat objekt kontesti e ka bartur në pronaret R. B. dhe P. B. . Paditësi M. B. asnjëherë nuk ka qenë pronar i asnjërës prej ngastre objekt kontesti . Fillimisht pronar i ngastrave objekt kontesti ishte paraardhësi i të paditurit H. B. - i ati i tij A. B. , më pas si trashëgimtar i tij H. B. dhe së fundmi R. B. dhe P. B. qka provohet fakti se H. B. dhe M. B. i mungon legjitimiteti e palës në procedurë.

Gjykata pas administrimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ekspertizës së ekspertit gjeodet, dëgjimit të paditësit dhe të paditurve në cilësi të palëve ndërgjyqëse dhe dëshmitarëve të lartcekur, vendosi që të refuzoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke ia falur besimin e plotë ekspertizës së ekspertit gjeodet, historiatit të pronës dhe deklaratave të të paditurve dhe dëshmitareve . Me ekspertizën e ekspertit gjeodet L. A. të dt. 15.09.2022 me skicën e terenit të dt. 20.10.2018 është konstatuar se parcela kadastrale ..... ZK Gjinoc në vendin e quajtur A. e G. në sipërfaqe prej 276 m2 me kulturë rajon ujor – lum është e evidentuar në emër të Refik Islam Berisha ndërsa parcela kadastrale .... ZK Gjinoc në vendin e quajtur A. e G. në sipërfaqe prej 276 m2 me kulturë rajon ujor – lum është e evidentuar në emër të P. M. B. . Po ashtu gjykata ia fali besimin edhe deklaratave të të paditurve H. B. dhe R. B. . H. B. ka deklaruar se para shumë vitesh, gjegjësisht në vitin 1974 parcela për të cilën po zhvillohet kontesti ka qenë jarugë, ajo parcelë ka pas diku rreth 0,70 ha, e njëjta është ndarë në tri pjesë. Në njërën anë të jaruges ka qenë I. (babai i R.), ndërsa në anën tjetër unë H. dhe pjesën tjetër M. (babai i M.), kufiri i ngastrave ka qenë për vij të jarugës.Sipas marrveshtjes për nadarje token me kontrat mbi faljen e kam bart te pronarët. R. ka deklaruar se kur jemi ndarë unë kamë qenë 7 vjeç, prona është ndarë në mes të prindit tim, prindit të paditësit dhe H. , ndërsa me kontratë te noteri është bërë në vitin 2019. Këto fakte u vërtetuan edhe nga historiati i pronës i lëshuar nga Drejtoria e kadastrit ku është cek se kjo paluajtëshmëri ka qenë e regjistruar në emër të A. A. B. nga fshati Gj. e cila në vitin 2012 me Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Suharekë T.nr.6/2012 kjo

paluajtëshmëri ka kaluar te trashëgimtari H. A. B. nga fshati Gj. . Në vitin 2018 parcela .... është parcializuar në .... rajon ujor në sipërfaqe 276 m2 dhe parcelën .... rajon ujor në sipërfaqe prej 276 m2 me pronar H. A. B. nga Gj. . Andaj këtyre provave gjykata iu fali besimin e plotë ngase të njëjtat ishin në përputhje dhe harmoni të plotë me njëra tjetrën .

Pretendimet e paditësit se për pjesën e parcelës që e ka bërë kërkesëpadinë është në posedim që nga viti 1974 dhe asnjëherë nuk është penguar nga dikush e të njëjtën e ka edhe sot në shfrytëzim me mirëbesim si dhe pikë kufizuese e parcelës ka qenë braza – jaruga të cilën e kemi pas përgjysmë dhe janë të vendosura shtyllat e betonit, gjykata i vlerësoi si të pabazuara dhe të pa mbështetshme në prova për shkak se nga provat gjegjësisht historiati i pronës që u administruan u vërtetua se ajo parcelë ka qenë e pronarit A. A. B. e që pas vdekjes së tij me Aktvendim të trashëgimisë T.nr.6/2012 ka kaluar te trashëgimtari H. A. B. këtu paditësi dhe se e njëjta asnjëherë nuk ka qenë nën pushtetin faktik të paditësit M. B. .

Me nenin 4 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore është paraparë që "*Në çoftë se fitimi i një të drejte sendore varet nga mirëbesimi i fituesit, do të prezumohet mirëbesimi, përveç nëse vërtetohet ndryshe*" e në rastin konkret është vërtetuar ndryshe nga pretendimet siç janë parashtruar në padi dhe në seancë nga paditësi.

Ndërsa me nenin 36.1 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore është paraparë që "*Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmeri*", ndërkaq nga provat e administruar nuk u vërtetua se paditësi ka fituar të drejtën e pronësisë përmes ndonjë pune të vlefshme juridike por përkundrazi u vërtetua se i padituri i dytë e ka të drejtën e pronësisë të cilën e kanë fituar në bazë të punëve juridike dhe regjistrimi në regjistrat e të drejtave i paluajtshmërisë është bërë në bazë të punëve të vlefshme juridike.Ndërsa për ngastrën .... pronar mbi të njëjtën bazë është P. B. e jo paditësi M. B.

Me nenin 40 par.1 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore është paraparë që "*Personi i cili me mirë besim e ka njëzet (20) vjet në posedim të pandërprerë një palujtëshmeri ose një pjesë të saj e fiton pronësinë në të "* e që në këtë rast nuk plotësohet ky kusht pasi që është provuar se paditësi nuk e ka pas në posedim të pandërprere këtë palujtëshmeri ,por veqanerisht pas viti 2019 kemi pronar tjerë të rexhistruar në librat katastral si pronar ,shfrytëzues dhe posedues të asaj palujtshmërie.

Përfundimisht gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në parcelat P-..... në sipërfaqe 41 m2 në vendin e quajtur A. e G./J. në ZK Gj. te refuzohet.

Vendimi mbi refuzimin e kërkesëpadisë është mbështetur në nenin 4 dhe 36.1 1 të LPDTS-së.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në nenin 450 të LPK-së

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË**
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**
**2019:135942, 14.10.2022**

Bashk.Profesional
Feim Bytyqi

Gjyqtari
Robert Tunaj

**KËSHILLË JURIDIKE**: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.